MAL BERISHA

KOHA JONE

08/05/2020



“TOKA E SHPRESËS DHE LAVDISË”

Victory day

NË 75-VJETORIN E FITORES MBI FASHIZMIN, NË WESTMINSTER ABBEY – LONDËR

Sot është shtatëdhjetëvjetori i fitores mbi fashizmin.

Në Abacinë e Westminsterit mbërrijnë njëri pas tjetrit veteranë, pjesëtarë të forcave të armatosura, anëtarë të familjeve pjesëmarrëse në Luftën e Dytë Botërore, intelektualë, pjesëtarë të administratës së lartë shtetërore, anëtarë të kabinetit qeveritar, deputetë të mazhorancës dhe opozitës, si dhe thuajse të gjithë ambasadorët dhe kryekomisionerët e akredituar në Oborrin e Shën Xhejmsit.

Banda muzikore e Uellsit ekzekuton muzikë të kompozuar nga Davidi i Gurit të Bardhë, një balladë nga Philip Sparke dhe një elegji nga George Thalben-Ball.
Nën tingujt e kësaj muzike, në Abaci shfaqet ndërkaq Madhëria e Saj, Mbretëresha Elizabeth II, e shoqëruar nga Duka i Edinburgut, Princi i Uellsit dhe Dukesha e Kornuellit. Është një moment solemn, nga ato kur e gjithë makina protokollare shtetërore e këtij vendi funksionon në mënyrë të përkryer.

Dhjetëra stuartë, zonja mondane me kapele, ushtarakë me grada, të rinj që shërbejnë në kishë, pjesëtarë të Protokollit të Shtetit – të gjithë kanë vënë energjitë e tyre në shërbim të kësaj dite të shenjuar.

Abacia Westminster dhe Parlamenti

Përse pikërisht në këtë Abaci do të festohet 70-vjetori i përfundimit të Luftës së Dytë Botërore?
Arsyeja është e thjeshtë: ajo ndodhet pranë Parlamentit Britanik. Në të prehen eshtrat e thuajse të gjithë mbretërve anglezë.

Aty u mbajt edhe Mesha e Fitores mbi Fashizmin. Aty organizohen edhe Lutjet e Falënderimeve për të mirat që Zoti u ka dhuruar britanikëve, së bashku me të huajt.
Dita e Lutjeve, në botën anglosaksone, është një ndër ditët më të shënuara. Ajo festohet në Amerikën e Veriut si një

traditë që e ka origjinën në Angli, që nga koha e Reformës Protestante.

Kjo festë ka rrënjë të lashta dhe përkujtohet çdo vit të enjten e katërt të nëntorit. Ajo mori rëndësi të veçantë gjatë Reformimit, në kohën e mbretërimit të Henrit VIII, si reagim ndaj numrit të madh të festave fetare të kalendarit katolik.

Para vitit 1536, në kalendarin kishtar ekzistonin 95 festa fetare, përveç 52 të dielave, gjatë të cilave njerëzit ishin të detyruar të merrnin pjesë në shërbesa dhe shpesh të paguanin shumë për to.

Nga kjo situatë lindi një lëvizje për thjeshtimin e festave, duke i reduktuar ato në vetëm dy ose tre, siç janë Krishtlindjet, Pashkët dhe Dita e Falënderimeve.

Kjo ditë mori emrin e saj pas fitores ndaj **Armadës Spanjolle** në vitin 1588 dhe u përforcua më tej nga vendimi i Mbretëreshës Anne në vitin 1705.

Një kremtim i përvitshëm i Ditës së Falënderimeve filloi në vitin 1606, menjëherë pas dështimit të **Komplotit të Barutit** në vitin 1605.

9 maj 1945 – 2015.

Atë ditë, Kryeministri Winston Churchill, pasi njoftoi publikisht dhe zyrtarisht, nëpërmjet një transmetimi të drejtpërdrejtë radiofonik, kapitullimin pa kushte të

Gjermanisë, u drejtua për në Dhomën e Komunave për t'iu folur anëtarëve të Parlamentit.

Nga aty, ai mori pjesë në një meshë për falënderim, për arritjen e kësaj fitoreje dhe për t'u lutur për shpirtërat e të gjithë atyre që dhanë jetën.

Festimet në Londër dhe në të gjithë Britaninë e Madhe shpërthyen menjëherë si një vullkan.
Populli u lëshua në rrugë.
Mijëra fishekzjarre ndriçuan qiellin.
Njerëzit, të mbytur në lot gëzimi dhe dhimbjeje, këndonin pa ndërprerje këngën:

"Unë nga gëzimi do ndizem i tëri gjer në agim."

(Refreni)

"Kur kombet ta humbasin ndjesinë e luftës — mjerim!
E bota të kthehet prapë në drejtimin e mbarë,
Oh, ç'dite feste do të jetë ajo më në fund,
Kur trimat të sjellin të paqes pranverë!

Dhe kur të vijë koha që dritat llamburisin pa pushim,
Unë nga gëzimi do ndizem i tëri gjer n' agim."

Në radhën e parë, vetëm tre karrige përpara meje, është ulur Mbretëresha Elizabeth II.

E qetë, e bardhë, e përunjur, ajo ndjek me vëmendje meshën.

Ngrihet dhe ulet sa herë që pastorët e kërkojnë këtë nga të pranishmit.

Këtë vit, ajo mbush 63 vjet që nga ngjitja në fron dhe e ndjek këtë meshë që kur ishte një vajzë e re dhe e bukur.

Kjo është një ditë e veçantë për Mbretëreshën Elizabeth II.

Shtatëdhjetë vjet më parë, ajo ishte ende Princesha Elizabeth.

Nga gëzimi i madh i fitores, kishte dalë nga Pallati Mbretëror, pa u vënë re se kush ishte, bashkë me motrën e saj, Princeshën Margaret, duke u përfshirë në turmën që festonte.

Të dyja ishin të shoqëruara nga roje të veshur thjeshtë, që nuk binin në sy.

Gjatë asaj dite, Churchill mbajti dy fjalime. Të parin e dha në Whitehall, nga ballkoni i Ministrisë së Shëndetësisë, ku e nisi me fjalët:

"Kjo është fitorja juaj!"
Ndërsa turma iu përgjigj:
"Jo! Është fitorja jote!"

Më pas, në fjalimin e dytë, Churchill e tërhoqi turmën në këndimin e himnit **"Toka e Shpresës dhe Lavdisë"**, të muzikuar nga legjenda e muzikës angleze, **Sir Edward William Elgar**.

Toka e Shpresës dhe Lavdisë, o Nënë e Lirisë,
Si mund të të shpërblejmë, ne që na linde Ti?
Si t'i zgjerojmë kufijtë e tu të pafundësisë?
Si të mbrojmë atë që Zoti të fali me dashuri,
Dhe fuqinë tënde ta kthejmë në mrekulli?

Që prej asaj kohe, në këtë Abaci, fitorja mbi fashizmin përkujtohet çdo dhjetë vjet me një meshë solemne. Mbretëresha Elizabeth e përkujton këtë ngjarje për herë të shtatë si Mbretëreshë.

Një paralele midis **"fitimtarëve"** të dikurshëm dhe sfidave të sotme shtrohet natyrshëm në reflektimet e kësaj dite – duke rikujtuar se paqja dhe liria nuk janë të përhershme, por duhet të ruhen me përkushtim të vazhdueshëm.

Në këtë ceremoni përkujtimore, të organizuar në mënyrë të përkryer deri në mikrodetaje dhe kaq mbresëlënëse, është e pamundur të mos të shkojë mendja te shumë prej fjalimeve që janë mbajtur në atë kohë – pikërisht në këtë datë, ose në ditë të tjera të shënuara si kjo, kur përkujtohet çlirimi i vendeve nga nazi-fashizmi.

Teksa shoh se si e festojnë britanikët këtë ditë, mendja më shtegëton drejt vendit tim – atje ku luftërat, kujtesa dhe protagonistët përbëjnë një amulli që zbeh fitoret dhe errëson të vërtetat, ato të vërteta që duhej të ndriçonin kombet.

Edhe në Tiranë, në kryeqytetin tim plot histori, një njeri mbajti një fjalim që na e kanë ngulitur në mendje që në shkollë si një moment patriotik.
Edhe shqiptarët patën të drejtë të shpërthenin në festime pas fitores kundër nazi-fashizmit. Patën arsye të ëndërronin për ditë më të mira…

Por, eh… dallimi është i thellë:

Nazizmi në Shqipëri u zëvendësua me një formë tjetër diktature – po aq e rëndë për popullin shqiptar.
Ndërsa këta këtu e ngritën vendin e tyre në lartësitë më të mëdha që një komb mund të arrijë, Shqipëria ra në duart e një diktature të ashtuquajtur të Proletariatit.

Veteranët
I shoh me respekt veteranët britanikë të luftës. Të moshuar, të plakur, por të veshur me dinjitet, me gjokset e mbushura me dekorata.

Dhe mendja më shkon përsëri te mijëra luftëtarë shqiptarë, shumë prej të cilëve përfunduan në burgje, kampe internimi, apo u ekzekutuan në mënyrë të pashëmbullt. Heronjtë u shpallën “tradhtarë” dhe lufta, sipas një historie të përmbysur, paskësh qenë bërë nga “armiqtë”…

Mesha është gjithmonë një moment meditimi.
Edhe unë sot meditova thellë.
Ndjeva keqardhje.

E dëgjova me ëndje, por jo pa një fije zili,
“Tokën e Shpresës dhe Lavdisë.”

Dhe u luta për vendin tim:

“Kurrë mos pafsh fitimtarë luftërash që të vrasin më shumë se armiku yt!
Amen!”

Westminster Abbey, Londër – Victory Day, 9 Maj
www.Malberisha.com
Argumentum.al